

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: “Ministria e Shëndetësisë”

Për Aktivitetin e Prokurimit: Nr. i prokurimit: 206-23-13309-1-1-1

Sa i përket tenderit për: “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH”

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Grupi i Operatorëve Ekonomik PACS and Workflow System

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Bekim Fehmiu, 110, Kati 6, Nr.7

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Trendelina Qerimi Selmani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

trendelina.qerimi@novus.consulting

(Adresa elektronike)



03.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Më datë 27 nëntor 2023 - Autoriteti Kontraktues “Ministria e Shëndetësisë” ka Hapur Procesin e Prokurimit Publik me nr. të prokurimit 206-23-13309-1-1-1, me Titull: “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” (“Aktiviteti Tenderues”), ku OE Pacs and Workflow System ka dorëzuar DT së bashku me të gjitha dokumentet mbështetëse për aplikim përmes të cilave ka dëshmuar se është ofertë e përgjegjshme dhe me çmimin më të lirë nga ofertat e përgjegjshme.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit ka qenë subjekt i pesë ankesave pranë OSHP-së. Në pesë vendime, OSHP-ja, mbështetur edhe tek gjetjet e ekspertit shqyrtues/teknik, ka konstatuar se OE ka paraqitur ofertë të përgjegjshme, dhe rrjedhimisht duhet shpërblyer me Kontratë. Vendimet e OSHP-së, për të njejtin aktivitet tenderues, me të cilin janë aprovuar si plotësisht të bazuara ankesat e OE përfshijnë,

- Vendimi i OSHP 712/24
- Vendimi i OSHP 60/25
- Vendimi i OSHP 548/25
- Vendimi i OSHP 1075/25

- Vendimi i OSHP 0167/26

Përmes Vendimit të OSHP 0167/26, kjo çështje tashmë konsiderohet “Res Judicata”, si çështje e gjykuar, dhe detyrimi i vetëm i Autoritetit Kontraktues ishte të shpërblente me Kontratë.

Më datën 17.07.2026, pas kthimit në rivlerësim nga Vendimi i OSHP me numër 0167/26, i datës 16.01.2026, Autoriteti Kontraktues Ministria e Shëndetësisë (“AK”) publikon Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Përmes këtij Vendimi, AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit me pretendimin se asnjë nga ofertuesit nuk ka paraqitur ofertë të përgjegjshme. Të njëjtën kohë përmes Letrës Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, po të datës 17.07.2026, AK njofton OE Pacs and Workflow System se është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit pasi që tenderi i të njëjtit është i papërgjegjshëm.

Me rëndësi esenciale është fakti se Vendimi i AK-së për eliminimin e nuk është vendim origjinal i AK-së, por është keqpërdorim i Inteligjencës Artificiale për të gjeneruar arsyetime për eliminim, në një situatë kur Vendimi i OSHP-së 0167/26 i konsideronte këto “Res Judicata”.

Më datë 22.07.2026, OE Pacs and Workflow System ka paraqitur për herë të gjashtë Kërkesën për Rishqyrtim.

Ndërkaq, më datë 24.07.2026, Autoriteti Kontraktues nxjerrë Vendimin për refuzim të Kërkesës për rishqyrtim të OE si të pabazuar, dhe duke lënë në fuqi Njoftimin e AK, të datës 17.07.2026.

Në këtë drejtim, OE Pacs and Workflow Systems paraqet për herë të gjashtë Ankesën në OSHP, megjithëse OSHP ka konsideruar çështjen si të gjykuar - res judicata.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☒

Jo

☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po

☒

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, duke përfshirë Ndryshimet dhe Plotësimet përmes Ligjit Nr. 04/L-237, Ligjit Nr. 05/L-068, dhe Ligjit Nr. 05/L-092 (“LPP”)

Neni 105.2.16. – Kompetencat e OSHP-së - Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.

Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve - AK nuk vlerëson ofertën e OE Pacs and Workflow System në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me Dosjen e Tenderit, pasi OE në fjalë ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga AK, për çka oferta e të njëjtit duhet të konsiderohet si e përgjegjshme.

Neni 62 – Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit - AK mund të anulojë/përfundojë aktivitetin e prokurimit vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht me ligj. Në rastin konkret, asnjë nga kushtet ligjore për anulim nuk është përmbushur, pasi ekziston të paktën një ofertë e përgjegjshme dhe nuk është dëshmuar ndonjë rrethanë ligjore që justifikon ndërprerjen e procedurës.

Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jodiskriminimi - Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik. Interpretimi i zgjeruar i kërkesave teknike përtej asaj që është përcaktuar në Dosjen e Tenderit cenon trajtimin e barabartë dhe konkurrencën e drejtë.

Neni 28 – Specifikimet Teknike - Specifikimet teknike duhet të aplikohen dhe interpretohen vetëm në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, pa vendosje kriteresh shtesë gjatë fazës së vlerësimit. Çdo devijim nga kërkesat e parapara në Dosjen e Tenderit përbën tejkalim të kompetencave vlerësuese të AK-së.

Rregullorja Nr.001_2022 për Prokurimin Publik (“Rregullorja për Prokurim”)

Neni 43.5 – Ndërprerja e procedurave të prokurimit - Procedura e prokurimit mund të ndërpritet vetëm nëse ekzistojnë arsyet ligjore të përcaktuara me rregullore dhe ligj. Në rastin konkret, nuk janë paraqitur arsyet ligjore që justifikojnë anulimin e aktivitetit të prokurimit.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

OE Pacs and Workflow System paraqet këtë Ankesë në OSHP kundër Vendimit për refuzim të Kërkesës për rishqyrtim, i datës 24.07.2026 për aktivitetin e prokurimit me nr. 206-23-13309-1-1-1 (“**Vendimi për refuzim**”), me të cilin AK refuzon Kërkesën për rishqyrtim, të datës 22.07.2026, dhe mban në fuqi Njoftimin e datës 17.07.2026, përmes së cilit anulon aktivitetin e prokurimit duke e vlerësuar ofertën e OE Pacs and Workflow System and Workflow System si të papërgjegjshme.

Me rëndësi esenciale, veprimet e Autoritetit Kontraktues paraqesin veprime të paligjshme dhe veprime të cilat refuzojnë të zbatojnë vendimet përfundimtare dhe meritore të OSHP-së, e cila veçse ka vendosur pesë (5) herë për të njëjtin tender, dhe në Vendimin 0167/26 (“**Vendimi i pestë i OSHP**”) ka shpallur ankesën si çështje të gjykuar “res judicata”, që nënkupton se çështja është shtjerrur përtej vlerësimit të mëtutjeshëm. Në pesë (5) rastet, OSHP-ja, mbështetur edhe nga ana e ekspertit shqyrtues, ka konstatuar se kemi paraqitur ofertë të përgjegjshme, dhe rrjedhimisht kualifikohemi për dhënie të Kontratës.

Me Vendimin e fundit nr. 0167/26, për herë të pestë, OSHP ka hedhur poshtë pretendimet e Autoritetit Kontraktues për eliminim e ofertës tonë si të papërgjegjshme, me ç’rast konsideroi çështjen “res judicata”: të gjykuar. Përkundër kësaj:

- Aktiviteti është eliminuar/anuluar për herë të pestë;
- Nuk janë respektuar konstatimet dhe arsyetimi obligativ i OSHP-së;
- Nuk është respektuar Vendimi i pestë i OSHP-së përmes së cilit shpallë çështjen “res judicata”.

Me respekt kerkohet, qe në përputhje me Nenin 131 të LPP-së dhe në përputhje me Rregullores së Punës së OSHP, te aplikohoen masa ndëshkimore ndaj Autoritetit Kontraktues dhe zyrtarëve përgjegjës, kjo për shkak të diskriminimit dhe refuzimit të zbatimit të vendimeve detyruese të OSHP-së.

Për më tepër, OE Pacs and Workflow System konsideron se mënyra e hartimit të Vendimit të fundit refuzues, një dokument prej rreth 30 faqesh, paraqet indicie serioze se ai është përgatitur, në tërësi ose në pjesë të konsiderueshme, me përdorimin e mjeteve të inteligjencës artificiale. Nga një analize e tekstit, kuptohet se urdhri ka qene te gjenerohen argumente per eliminim, pa një analizë reale dhe individuale të fakteve të rastit, të ofertës sonë dhe, mbi të gjitha, pa respektuar arsyetimin detyrues të pesë (5) vendimeve paraprake të OSHP-së. Ndërkaq, ky pretendim i OE është adresuar nga AK përmes Vendimit për refuzim, ku të njëjtit nuk ofruan provë që vërteton të kundërtën, por vetëm kanë justifikuar përdorimin e inteligjencës artificiale gjatë ushtrimit të funksionit publik dhe rishqyrtues.

Kjo sjellje, e kombinuar me faktin se Autoriteti Kontraktues ka tentuar pesë (5) herë të eliminojë të njëjtën ofertë, pavarësisht se OSHP-ja ka konstatuar vazhdimisht se oferta është e përgjegjshme dhe, në vendimin e fundit, e ka konsideruar çështjen si *res judicata*, përbën një tregues serioz të veprimit me keqbesim, tejkalimit të kompetencave ligjore dhe abuzimit me pozitën zyrtare. Qëllimi i Autoritetit Kontraktues nuk rezulton të ketë qenë zbatimi korrekt i Ligjit për Prokurimin Publik dhe i vendimeve detyruese të OSHP-së, por

gjetja e çfarëdo arsytimi për të arritur të njëjtin rezultat të paligjshëm – eliminimin e ofertës sonë.

Në konsideratë të kësaj, përveç kërkesës sa më poshtë, OE kërkon masa ndëshkimore ndaj Autoritetit Kontraktues dhe zyrtarëve përgjegjës për shkak të diskriminimit dhe refuzimit të zbatimit të vendimeve detyruese të OSHP-së.

AK, duke kundërshtuar të gjitha pikat ankimore të OE, ka vlerësuar se OE Pacs and Workflow System nuk ka dorëzuar një ofertë të përgjegjshme. Në kundërshtim të këtyre, OE Pacs and Workflow System paraqet pretendimet si në vijim:

- A. Oferta e OE është e përgjegjshme sepse OE ka përmbushur të gjitha kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit;
- B. Nuk janë përmbushur kushtet ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit, pasi ekziston ofertë e përgjegjshme dhe nuk është dëshmuar devijim material që justifikon anulimin;
- C. AK ka shkelur rëndë parimet bazë të LPP-së.

Pretendimi ankimor 1 i OE:

A) OFERTA E OE ËSHTË E PËRGJEGJSHME SEPSE OE KA PËRMBUSHUR TË GJITHA KËRKESAT OBLIGATIVE TË DOSJES SË TENDERIT

Në këtë Ankesë të gjashtë në OSHP, OE do ri-pohojë se ka plotësuar të gjitha pjesët obligative të dosjes së tenderit. Në Vendimin e gjashtë të AK për refuzim, AK ri-vlerëson Ofertën të papërgjegjshme mbi këto pretendime:

- 1) Oferta nuk përmbush specifikimet teknike të RIS/WMS jashtë Data Center-it të AIS-it;
- 2) Mospërputhja e njohjes së zërit (voice recognition) me kërkesën dygjuhëshe;
- 3) Mungesa e DICOM/HL7 Conformance Statement dhe listës së profileve IHE
- 4) Mospërputhja e monitorit të dytë (“tool monitor”) të workstation-eve diagnostikuese;
- 5) Draft-kontrata e mirëmbajtjes dhe plani i mirëmbajtjes parandaluese — mungesë në ofertën fillestare;
- 6) Mospërputhja e RTO/RPO dhe gatishmëria operationale;
- 7) Mospërputhje e Serverit qendror (Dell PowerEdge R760xd2) për Central Server
- 8) Pretendohet se nuk është përmbushur kërkesa për dëshmi të implementimit të sistemit në arkitektura me shumë faqe, dhe se referencat e paraqitura nuk përmbushin kërkesën për projekte të natyrës së njëjtë gjatë tre (3) viteve të fundit;
- 9) Pretendohet se nuk është përmbushur kërkesa për certifikatë CE Klasa Ila sipas Direktivës 93/42/EEC, pasi OE ka dorëzuar certifikatë CE Klasa IIb;

Pas krahasimit të Njoftimit të gjashtë të AK me Njoftimin e pestë të AK, shihet se AK, në mes të pretendimeve të kaluara, ka shtuar pretendime për të cilat më parë nuk e ka konsideruar ofertën e OE si të papërgjegjshme. Në katër njoftimet e para, AK nuk ngritë

çdo çështje që ka ngritur tani, përfshirë edhe pretendimin lidhur me certifikatën CE Klasa IIa, ndërkaq në pesë njoftimet e para nuk cek mospërputhjen e RIS/WMS jashtë Data Center të AIS-it, mospërputhjen e njohjes së zërit, draft-kontratën e mirëmbajtjes, mungesën e DICOM/HL7, dhe mospërputhjen e RTO/RPO. Prandaj duhet theksuar se AK nuk e ka vlerësuar ofertën si të papërgjegjshme në bazë të çështjeve të reja të ngritura aktualisht në Njoftimin e gjashtë të AK, të cilin mbanë në fuqi përmes Vendimit për refuzim.

Kështu, në vijim do të argumentojmë se kjo Ankesë në OSHP duhet të aprovohet tërësisht, sikurse përgjatë pesë (5) shqyrtimeve të kaluara nga OSHP – ku edhe konsideruan çështjen res judicata, sepse OE Pacs and Workflow System ka paraqitur ofertë të përgjegjshme që duhet të shpërblehet me kontratë, për shkak se asnjë nga pretendimet e lartcekura të AK nuk qëndron.

1.) PRETENDIMI 1 I AK: AK, **për herë të parë**, dhe përmes një argumenti tërësisht të paqëndrueshëm që nuk merr fare për bazë dokumentet e shkruara që gjenden në ofertë, aludon se RIS/WMS jashtë Data Center-it të AIS-it, dhe kjo vlen si arsye për përjashtim. Megjithatë, kjo gjetje për herë të parë përveç se po ashtu është në shkellje procedurale në kuptim të nenit 60.7 të Rregullores për Prokurim. Në përputhje me nenin 60.7 të Rregullores për Prokurim, kthimi në rivlerësim nga OSHP nuk nënkupton ndryshim të rezultatit fillestar, por vetëm korrigjimin e parregullsive të konstatuara.

Përkundër shkeljes së shumëfishtë procedurale përmes shtimit të bazave të reja të supozuara, Pretendimi 1 i AK për eliminim po ashtu nuk ka bazë materiale të qëndrojnë si arsye e ligjshme eliminuese, për shkak se:

- Pinga mbështet vendosje on-premise, konfirmim zyrtar nga prodhuesi: Pinga Health Platform Specification (Dokumenti 2.1, bashkëngjitur Sqarimeve Shtesë te dates 15.06.2026), faqe 14, liston shprehimisht funksionalitetin: “*Containerized / onprem deployment. Containerized deployment with an NGINX WAF reverse proxy in Docker and a GitLab CI/CD pipeline with remote build cache*” me status: **Disponueshëm Gjithëpërfshirës (GA)**. Kjo konfirmon se Pinga WMS/RIS mund të vendoset si kontejner Docker në çdo server, saktësisht si MedDream PACS. Propozimi i OE-së për vendosje on-premise në serverët Dell në AIS është teknikisht i realizueshëm dhe i mbështetur nga specifikimi zyrtar i prodhuesit Sorsix;
- Oferta parimoree OE-se është on-premise në AIS e deklaruar në tri vende:
 - (i) Seksioni 2.5, fq. 6 i Propozimit Teknik fillestar: *"It is our understanding that an on-premise deployment is preferred, so the PINGA tenancy will be deployed on-premise."*
 - (ii) Përgjigja Q1 e Sqarimeve 15.06.2026: *"Propozimi ynë parësor është instalimi i Pingës on-premise në infrastrukturën AIS. Instalimi on-premise në AIS mbetet propozimi bazë i ofertës."*

(iii) Përgjigja Q22.2: tabela RTO/RPO etiketohet shprehimisht **"PINGA Platform (on-premises)"** me SLA Sev-1: 1 orë / Sev-2: 4 orë.

- Opsioni cloud është rekomandim fakultativ, jo oferta bazë: Seksioni 2.5, fq. 6 propozon: *"However, a cloud deployment model using Microsoft Azure is possible and we recommend that the Ministry of Health consider this option."* Ky është rekomandim për shqyrtim nga Ministria dhe jo zëvendësim i ofertës bazë. Përgjigja Q44 u dha në përgjigje të pyetjes specifike të AK-së mbi ndarjen e infrastrukturës PACS/RIS dhe jo si deklaratë e re e ofertës. Konfirmimet pasuese (Q45.2, Q47.1 x3, Q47.2, Q49.1, Q50.3) janë përgjigje ndaj pyetjeve që rrjedhin nga Q44 dhe jo deklarata të pavarura.
- DT Seksioni 4.4.3.34 lejon shprehimisht cloud workflow: *"Browsers are suitable native apps for zero-footprint image viewers and cloud-based workflow solutions."* Është e pamundur juridikisht të interpretohet Seksioni 3.1.1 si ndalues i asaj që Seksioni 4.4.3.34 shprehimisht lejon. Kontradikcion i brendshëm i DT-së nuk mund të zgjidhet kundër ofertuesit.
- DT parashikon vetë cloud solution në dokumentacionin e projektit: Seksioni i dokumentacionit të projektit në DT kërkon: *"a snapshot of the configuration of the cloud solution... maintained in a mutually agreed upon cloud location"* dmth vetë AK-ja e ka parashikuar cloud component si pjesë integrale të zgjidhjes.
- Imazhet DICOM dhe të dhënat PACS janë tërësisht on-premise në AIS: IBM FlashSystem 5045 me 600+ TB RAID 6 (HyperSwap sinkron) është instaluar fizikisht në Data Center të AIS. Pinga WMS/RIS on-premise dhe MedDream PACS on-premise do të vendosen mbi serverët Dell PowerEdge në AIS dhe i gjithë sistemi i krijon te dhenat në AIS server room sipas Seksionit 3.1.1.
- DT Seksioni 3.3.9 - "no Cloud Management" kufizohet vetëm tek antivirusi: Fraza *"no Cloud Management"* në Seksionin 3.3.9 i referohet ekskluzivisht skanerit antivirus. Duke kufizuar cloud management vetëm për antivirusin, DT konfirmon se cloud është i pranueshëm për komponentët e tjerë, një ndalim i përgjithshëm cloud do të ishte formuluar si rregull e përgjithshme, jo i kufizuar në një detaj të antivirusit.
- Arsyetimi specifik i Përgjigjes 44. Pyetja nuk kishte lidhje me cloud vs. on-premise: Q44 u formulua nga AK-ja mbi bazën e një supozimi konkret: se HAProxy, Tomcat cluster dhe PostgreSQL DB në Propozimin Teknik duke sugjeruar që MedDream PACS dhe Pinga WMS/RIS mund të ishin instaluar mbi të njëjtin server fizik R760xd2. AK-ja kërkoi konfirmim: *"Konfirmoni nëse MedDream PACS dhe Pinga WMS/RIS janë deployed mbi të njëjtin server fizik qendror (R760xd2) apo mbi infrastruktura të ndara."* Kjo është pyetje

arkitekture për lokacion fizik dhe jo pyetje për cloud vs. on-premise. Për t'iu përgjigjur, OE-ja detyrimisht duhet të shpjegonte se ku ndodhet secili sistem. Përfshirja e Azure-it në përgjigje ishte pasojë e domosdoshme e pyetjes së AK-së dhe jo deklaratë e spontanëshme mbi ndryshim oferte.

- **44.1 - Pse u përmend Azure:**

Përgjigja 44.1 shpjegoi që PACS është on-premise (Dell R760xd2) dhe Pinga WMS/RIS ka infrastrukturën e vet të ndarë duke përshkruar arkitekturën teknike të produktit Pinga. Kjo ishte përgjigje e drejtpërdrejtë e pyetjes për ndarjen e infrastrukturës. R760xd2 hostohet vetëm MedDream PACS dhe kjo është saktësisht ajo që kërkon Seksioni 3.1.1 DT për PACS.

- **44.2 - Mekanizmat e izolimit (jo një pyetje cloud vs. on-premise):**

Q44.2 kërkoi: *"Nëse janë mbi të njëjtin server: shpjegoni mekanizmat e izolimit."* OE konfirmoi që kushti "server i njëjtë" nuk zbatohet direkt dhe që sistemet janë në infrastruktura krejtësisht të ndara. Përgjigja 44.2 përshkruan mekanizmat Docker për PACS (on-premise) dhe VNet/subnet për Pinga përderisa kjo është përgjigje për izolim arkitekturor, dhe jo deklaratë e re për vendosjen.

- **44.3 - Bazat e të dhënave dhe PingaEDGE si WMS broker on-premise:**

Përgjigja 44.3 konfirmon ndarjen e bazave të të dhënave (PACS vs. RIS). Kritikisht: Q31.1 e sqarimeve konfirmoi që të dhënat demografike kanë lokacion on-premise: *"ekskluzivisht lokale (WMS broker + PACS deployment)."* WMS broker on-premise = **PingaEDGE** nyja lokale DICOM e integritit e cila instalohet fizikisht në AIS/R760xd2, konfirmuar në Përgjigjen 44.1: *"nëpërmjet nyjes on-premise PingaEDGE."* Pra Pinga WMS/RIS **KA prani fizike në AIS** nëpërmjet PingaEDGE dhe plotëson perfundimisht kërkesën e Distribution List *"Data Center localized at premises of ISA."*

- **44.4 - Kapaciteti: T550 janë PACS cache, jo RIS servers:**

Përgjigja 44.4 konfirmon kapacitetin e mjaftueshëm duke sqaruar që 7 serverët rajonalë T550 mbajnë vetëm cache PACS lokal (kopje aktive për 7 spitalet rajonal pa varësi nga lidhja qendrore), ndërsa Pinga WMS/RIS është e centralizuar në një tenancy të vetëm. Kjo është saktësisht *"CENTRALIZED RIS PROGRAM SOLUTION"* sipas Distribution List të DT-së, një pikë e vetme qendrore nëpërmjet PingaEDGE në AIS.

- Konfirmimet pasuese janë zinxhir i vetëm sqarimi, jo deklarata të pavarura materiale: Të gjitha 9 referencat për Azure cloud të cituara nga AK (Q44.1,

Q44.3, Q45.2, Q47.1×3, Q47.2, Q49.1, Q50.3) janë pjesë e një zinxhiri të vetëm sqarues teknik të nisur nga pyetja e AK-së për ndarjen e infrastrukturës. Q45.2 sqaroi zgjerueshmërinë e storage-it. Q47.1 (i)(ii)(iii) sqaroi skenarët e katastrofës. Q49.1 dhe Q50.3 sqaruan të njëjtën arkitekturë. Fragmentimi i këtyre 9 nënpërgjigjeveve si *"9 deklaratat të pavarura mbi ndryshim material"* është jo i sakte dhe jo i drejt si dhe në kundërshtim me qëllimin e procedurës së sqarimeve sipas LPP nenit 59(2). Një sqarim i vetëm arkitekturor i nënndarë në 9 pyetje asesi nuk mund të kualifikohet si 9 ndryshime materiale.

- Konfirmim përfundimtar nga OE: të dhënat PACS dhe RIS ruhen on-premise në AIS sipas ofertës bazë se ofruar:

Oferta bazë e OE-së parashikon që të dhënat e të dy sistemeve ruhen në AIS:

(i) Të dhënat PACS: imazhet DICOM ruhen ekskluzivisht on-premise në AIS: IBM FlashSystem 5045 (608 TB neto, RAID 6, HyperSwap sinkron) dhe Dell DD3300 (WORM Retention Lock) janë instaluar fizikisht në Data Center të AIS, konfirmuar në Q14 dhe Q31.1: *"imazhet DICOM ruhen ekskluzivisht on-premise dhe nuk transmetohen apo ruhen në cloud."*

(ii) Të dhënat RIS/WMS: Pinga WMS/RIS ka prani fizike në AIS nëpërmjet PingaEDGE (WMS broker on-premise i lidhur me R760xd2). Të dhënat demografike kalojnë nëpërmjet PingaEDGE lokalisht, kjo e konfirmuar në Q31.1: *"ekskluzivisht lokale (WMS broker + PACS deployment)." Në skenarin e vendosjes on-premise (propozimi bazë sipas Seksionit 2.5 dhe Q1), i gjithë tenancy Pinga vendoset në Docker në serverët Dell në AIS dhe të gjitha të dhënat RIS/WMS do të ruhen lokalisht në AIS, duke plotësuar plotësisht kërkesën në Seksionin 3.1.1 DT: "All data will be stored centrally in the AIS server room."*

- 2.) PRETENDIMI 2 I AK:** Po ashtu për **herë të parë** përgjatë këtij cikli të gjashtë rishqyrtues, AK edhe në Vendimin për refuzim bazon eliminimin mbi mospërputhjen e njohjes së zërit (voice recognition) me kërkesën dygjuhëshe. AK pretendon se oferta e OE ka mosmbështetje për gjuhën serbe, kosto të padeklaruara si dhe hostim jashtë Data Center të AIS-it. Këto arsyetime nuk janë asgjë më shumë një tentativë tjetër për të arsyetuar eliminimin e kundërligjshëm, duke kontestuar fakte që AK-ja veç se ishte në dijeni për to, e që nuk ka kontestuar më parë. Përsëri, përveç se kjo gjetje – si gjetje e re – është në shkelje të plotë procedurale, po ashtu nuk ka bazë meritore sepse:

- Kërkesa dygjuhëshe ishte e njohur dhe oferta e plotëson: DT Seksioni 5.1.2 kërkon

integrim me voice recognition. Sqarimi i AK-së 09.01.2024 (Q12) e bëri të detyrueshme mbështetjen si për shqip ashtu edhe për serbisht. OE e dinte këtë kërkesë dhe ofroi platformën e cila mbështet natyrshëm si sq-AL (Albanian) ashtu edhe sr- RS (Serbian) si gjuhë GA standarde. Përgjigja e paraqitur nga OE me kërkesë të AK konfirmon me dokumentacionin zyrtar të Microsoft-it. OE ka deklaruar shprehimisht se e plotëson këtë kërkesë qysh nga momenti i ofertimit;

- Azure Cognitive Speech ishte gjithmonë komponent i dokumentuar i produktit Pinga: Pinga Health Platform Specification (Dokumenti 2.1, Sqarimet 15.06.2026), faqe 14, liston shprehimisht: “Cloud provider integration: Microsoft Azure (Cognitive Speech) ✓ GA”. Azure CS nuk u zbulua gjatë sqarimeve, por ishte pjesë e arkitekturës së produktit të propozuar. Përgjigja Q2.1 vetëm emërtoi motorin që Dosja e Tenderit nuk e kishte kërkuar të specifikojë;
- Seksioni 8 detajoi shqipen klinike — nuk e mohoi serbishten: Fokusi i Seksionit 8 (92%+ accuracy) ishte për gjuhën kryesore operative të MSH-së. Serbishtja (sr-RS) është karakteristikë standarde GA e Azure Cognitive Speech produkti i propozuar e mbështet strukturalisht pa ndryshim konfigurimi. OE e dinte kërkesën dygjuhëshe dhe prandaj ofroi produktin që e plotëson atë kërkesë;
- Kostoja është e përfshirë në ofertën totale: Përgjigja e ofruar nga OE në sqarim të tenderit konfirmon: “Voice Recognition (Azure Cognitive Services Speech API), e përfshirë në Pinga WMS/RIS SaaS pa kufizim (unlimited)”. Kostoja e CS është pjesë e çmimit të RIS Pinga e konfirmuar me sqarime. Nuk ka asnjë kosto të padeklaruar;
- DT nuk kërkon procesim lokal, por VR i propozuar vendoset on-premise: DT kërkon integrim funksional, jo hostim lokal të motorit të njohjes së zërit. Për më tepër, OE deklaroi qartazi se ofron CS Speech on-premise. Në skenarin e vendosjes on-premise të Pingës (propozimi bazë), VR mund të procesojë plotësisht brenda infrastrukturës AIS, pa dalë jashtë rrjetit edhe pse DT nuk e kërkon shprehimisht këtë.

3.) PRETENDIMI 3 I AK: Duke vazhduar trendin e kundërligjshmërisë, AK njëashtu arsyeton eliminimin mbi një **bazë tjetër të papërmendur** përgjatë këtij procesi gjashtëfazor të rishqyrtimit, ku AK argumenton se ka mungesë të DICOM/HL7 Conformance Statement dhe listës së profileve IHE. Konform nenit 72 të LPP-së, sqarimi lejon tregimin e faqes konkrete të Propozimit Teknik — saktësisht çfarë bëri OE-ja me Q3, në përgjigje të kërkesës për sqarim shtesë nga AK-ja, pa bërë asnjë ndryshim në ofertën bazë të dorëzuar. OE ka konfirmuar se plotëson të gjitha kërkesat e DT-së. AK përsëri është në kundërligjshmëri materiale për shkak se:

- Storage Commitment dhe DICOM Print janë të konfirmuara në ofertën origjinale: DT Seksioni 3.6.3 kërkon monitorim të “DICOM storage commitment” dhe “Printing” OE i përgjigjet drejtpërdrejt në ofertën origjinale: *“Full logging trees are available in the interface or as part of Pinga monitoring suites. For the*

proposed solution we envisage enabling all of these views within the primary Pinga interface.” Nuk mund të monitorosh funksione që nuk i mbështet dhe kjo është konfirmim i qartë se sistemi mbështet Storage Commitment dhe DICOM Print. Mungesa e tyre nga tabela e Q3 është mangësi prezantimi, jo mungesë funksionaliteti. Funksionaliteti ishte i deklaruar dhe konfirmuar në ofertën origjinale;

- MedDream v8.8.1 i njëjti produkt, version i përditësuar: Produkti i propozuar është MedDream PACS nga Softneta UAB. v8.8.1 është versioni aktual GA i atij produkti v8.3.1 Dorëzimi i CS-it për versionin aktual valid është praktikë standarde e industrisë. Produkti është i njëjtë; versioni është i përditësuar. DT nuk specifikon asnjë numër versioni;
- HL7 CS dhe profiler IHE të deklaruar me ofertën origjinale, pa asnjë ndryshim: Propozimi Teknik Seksioni 3.5.1 (fq. 69) konfirmon: *“all required licensing is included in the bid”*. Seksioni 3.5.2 (fq. 70) liston të gjitha tipet e mesazheve HL7 të kërkuara (ADT, ACK, ORM, ORR, ORU). PingaRIS HL7 & IHE Conformance Statement bashkëngjitur sqarimeve konfirmon të pesë profilet (SWF, PIR, PIX, ATNA, PDQ). Kostot e licencave HL7: zero — të përfshira në çmim. Nuk ka asnjë ndryshim në ofertën bazë.

4.) PRETENDIMI 4 I AK: AK argumenton se një ndër arsyet materiale për eliminim është mospërputhja e monitorit të dytë të workstation-eve diagnostikuese. Megjithatë, për shkaqet e listuara më poshtë, edhe ky pretendim i AK është i papabazë, ashtu që:

- Seksioni 4.4.1.15: DT-ja e dërgon shprehimisht tek *“detailed technical specifications sheet”* për specifikimet e workstation-eve (Seksioni 4.4.1.15). Ai dokument e kategorizon: *“Workstation Monitor (x70): minimum 23.8 inches”* ku modeli i ofruar Dell P2422H (23.8”) plotëson plotësisht këtë kërkesë;
- Dy monitors me dy specifikimet e ndryshme: Seksioni 4.4.1.14 specifikon dy pajisje të ndryshme: monitorin diagnostikues (6MP, 31.5” — Barco Coronis, 70 copë) dhe monitorin e punës tool monitor (70 copë, 23.8”). Referenca e Seksionit 4.4.1.15 tek *“detailed specs sheet”* ekziston pikërisht për të definuar tool monitor me specifikim të veçantë e të ndryshëm;
- Lista e Çmimeve e konfirmon: Artikujt 6-7: *“1x6MP 31.5” Color Medical Monitor and second monitor”* ku *“second monitor”* trajtohet si artikull i veçantë me specifikim të ndryshëm nga monitori mjekësor.

5.) PRETENDIMI 5 I AK: Për herë të parë përgjatë gjashtë rishqyrtimeve të AK, AK ofron si arsye eliminimi mungesën fillestare të Draft-kontratës së mirëmbajtjes dhe planit të mirëmbajtjes parandaluese. Përveç se dhe kjo arsye është e kundërligjshme proceduralisht sepse bie në ndesh me nenin 60.7 të Rregullores për Prokurim, po ashtu është materialisht e papabazë për shkak se:

- Draft kontrata mbulon të gjithë komponentët (11.2.4): OE ka deklaruar shprehimisht në Q20.1: “dokumenti mbulon të gjithë komponentët e ofruara të sistemit PACS & RIS të SISH, për periudhën e garancisë prej 36 muajsh” dhe jo vetëm Pinga cloud. SLA-ja e modelit garanton Sev1 24/7 për çdo komponent HW, me mbështetje on-site sipas orarit të Kosovës (E Hënë–E Premte 09:00–17:00 CET për Sev3-4; 24/7 on-call inxhinier për Sev1-2). Dokumenti është shprehimisht “draft” i hapur për negociatë, saktësisht ajo që kërkon pika 11.2.4.;
- “NZ business hours” është thjeshtë referencë template, e cila është sqaruar: Q20.2 konfirmon se “NZ business hours” është tekst standard i prodhuesit të softuerit (Softneta UAB, Lituani), i pazbatueshëm për angazhimet on-site të këtij tenderi. Mbështetja reale ofrohet nga Novus sh.p.k., Prishtinë, sipas orarit të Kosovës — e dokumentuar me tabelë të qartë në Q20.2.;
- Plani i mirëmbajtjes ekzistonte në ofertë (11.2.5): Plani bazë është bashkëngjitur si Aneks A i Draft Kontratës së Mirëmbajtjes pjesë e ofertës origjinale. Dokumenti Q20.3 është zgjerim me udhëzime teknike specifike të planit ekzistues sqarim i lejuar sipas nenit 72 të LPP-së, jo dokument i ri i prodhuar pas afatit.

6.) PRETENDIMI 6 I AK: Edhe në këtë pikë, AK mbron pakompromis arsyen eliminuese, e cila po ashtu është **arsye e re eliminuese e shtuar gjatë rivlerësimit**. AK ri-pretendon dhe në Vendimin për refuzim mospërputhjen e RTO/RPO dhe gatishmërisë operacionale. Përsëri, përveç se çdo arsye e re e shtuar nuk duhet të shqyrtohet fare për shkak të shkëlqes procedurale në të cilën përbëhen, kjo arsye është po ashtu materialisht e pabazë. DT Seksioni 3.2.5 kërkon “operational readiness within maximum 4 hours after failure”, dhe jo Disaster Recovery të plotë. RTO<24h në Backup & Recovery Plan i referohet ekskluzivisht skenarëve DR (humbje totale e site-it), jo dështimeve operative. SLA operacionale (T.4, Neni 1.3.5), e konfirmuar në Q22.1 dhe Q22.2, garanton Sev-1: 1 orë dhe Sev-2: 4 orë, 24/7, për të gjithë komponentët e MedDream PACS, Pinga (on-premises) dhe infrastrukturën HW duke plotësuar dhe tejkaluar kërkesën ≤4 orë të DT-së. Eshte dorezuar dhe Koncepti Formal i Rimëkëmbjes me RTO ≤4 orë të konfirmuar dhe procedurën e failover.

7.) PRETENDIMI 7 I AK: AK përmes Vendimit për refuzim konteston përsëri përputhshmërinë e serverit të ofruar nga OE për Serverin Qendror, duke iu referuar kërkesës së përcaktuar në Specifikimet Teknike të DT-së. Sipas AK-së, serveri i ofruar – Dell PowerEdge R760xd2 – nuk përmbush kërkesën për “opsionin për një panel të përparmë të kyçshëm në kasën e serverit, që kufizon qasjen në hard disqe”. Ky pretendim është i pabazuar.

Veçanërisht theksojmë se kjo çështje është trajtuar dhe konsideruar si e përmbushur në pesë (5) vendime të OSHP-së në këtë aktivitet të prokurimit, dhe konsiderohet çështje res judicata. Si rrjedhojë, ajo nuk mund të rihapet apo të rivlerësohet ndryshe në këtë fazë, pasi do të cenonte sigurinë juridike dhe

detyrueshmërinë e vendimeve të organit kompetent të shqyrtimit. Për këtë arsye, OSHP gjatë vendosjes duhet vetëm të ripërsëris qëndrimin e mëparshëm.

8.)PRETENDIMI 8 I AK: AK, përmes Vendimit për refuzim, **për herë të dytë gjatë këtij aktiviteti të prokurimit i cili tani po fillon ciklin e vet të gjashtë të rishqyrtimit**, ka vlerësuar se OE nuk ka paraqitur certifikatë të vlefshme që dëshmon se zgjidhja e propozuar është e certifikuar me CE Klasa IIa sipas Direktivës 93/42/EEC, por ka dorëzuar certifikatë CE Klasa IIb.

Edhe për këtë çështje, Vendimi i pestë i OSHP-së ka vendosur se plotësohet si kërkesë dhe e ka konsideruar çështje të gjykuar – res judicata, në favor të OE. Si e tillë, duke qenë se OSHP veçse ka aprovuar këtë pretendim ankimor të OE si të bazuar, çfarëdo argumenti shtesë i AK do të jetë i pamjaftueshëm, dhe nuk mund të trajtohet si bazë eliminimi.

9.)PRETENDIMI 9 I AK: AK, edhe në këtë fazë, pretendon se OE nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat 9.1 dhe 9.2 të Seksionit II të FTD-së, duke vlerësuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme ligjërisht të vlefshme për të demonstruar se produkti i ofruar është implementuar në disa arkitektura multi-site.

Është me rëndësi të theksohet se kjo pikë – përkatësisht përmbushja e kërkesave sipas pikave 9.1 dhe 9.2 – është trajtuar në të gjitha vendimet e OSHP-së lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe është konsideruar si e përmbushur nga OE. Për më tepër, është konsideruar res judicata. Në pesë vendimet e OSHP-së, kjo çështje është analizuar dhe OE është vlerësuar si konformues në këtë aspekt.

Rrjedhimisht, ngritja e së njëjtës çështje në këtë fazë, pa rrethana të reja faktike apo ligjore, përbën jo vetëm rivlerësim të tejkaluar të një çështjeje tashmë të shqyrtuar, por edhe cenim të parimit të sigurisë juridike dhe të detyrueshmërisë së vendimeve të OSHP-së.

Për këto arsye, oferta e OE Pacs and Workflow System është plotësisht e përgjegjshme edhe në aspektin e përmbushjes së pikave 9.1 dhe 9.2 të FTD-së, dhe kjo çështje nuk duhet të trajtohet më si bazë eliminimi.

Pretendimi ankimor 2 i OE:

2. NUK JANË PËRMBUSHUR KUSHTET LIGJORE PËR ANULIMIN E AKTIVITETIT TË PROKURIMIT, PASI EKZISTON OFERTË E PËRGJEGJSHME DHE NUK ËSHTË DËSHMUAR DEVIJIM MATERIAL QË JUSTIFIKON ANULIMIN

Neni 62 i LPP-së, lexuar së bashku me nenin 43.5 të Rregullores për Prokurim, shprehimisht ka përcaktuar shkaqet për të cilat mund të përfundohet një aktivitet i prokurimit. Duke qenë se oferta e PACS and Workflow System është e përgjegjshme, nuk plotësohen kushtet për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Duke qenë se oferta e OE Pacs and Workflow System është vlerësuar si e përgjegjshme dhe përmbush të gjitha kërkesat administrative dhe teknike të Dosjes së Tenderit, nuk ekziston asnjë nga kushtet ligjore që do të arsyetonin anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Përfundimisht, duhet theksuar se kjo çështje është shqyrtuar tashmë pesë (5) herë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, në herën e pestë është konsideruar “res judicata” dhe në secilin rast OSHP ka konstatuar se oferta e OE Pacs and Workflow System është e përgjegjshme dhe se veprimet e Autoritetit Kontraktues nuk kanë qenë në përputhje me dispozitat e LPP-së. Përsëritja e të njëjtave apo e ngjashme arsyetime për eliminim, pas katër vendimeve të OSHP-së, përbën devijim nga parimi i sigurisë juridike dhe nga obligimi ligjor për zbatimin e vendimeve detyruese të organit shqyrtues.

Pretendimi ankimor 3 i OE:

C. AK KA SHKELUR RËNDË PARIMET BAZË TË LPP-SË

AK ka shkelur rëndë parimin e jo-diskriminimit në kuptim të nenit 7 të LPP-së, dhe parimin e sipas nenit 104 të LPP-së, për shkak se AK mospërfillë Vendimin e pestë të OSHP duke pretenduar shkelje të reja në një çështje të gjykuar – “res judicata”, dhe AK vazhdon shkeljen e parimit të jo-diskriminimit dhe efikasitetit përkundër evidentimit të kësaj shkelje nga OSHP dhe urdhërit për respektim të dispozitave të LPP-së. Si rezultat, OSHP duhet të shqyrtojë këtë Ankesë në konsideratë të këtyre shkeljeve të përsëritura, ashtu që të aprovojë të njëjtën të bazuar në tërësi sikurse në vendimet e mëparshme.

Përkundër faktit se përgjatë pesë cikleve të mëparshme të rishqyrtimeve dhe ankesave të ndërsjellta mes OE, AK dhe OSHP-së, OSHP gjithmonë ka aprovuar ankesat e OE si të bazuara dhe ka kthyer tenderin në rivlerësim, AK vetëm se ka vazhduar të pretendojë arsye të reja eliminuese të cilat nuk shërbyen si bazë eliminuese në vendimet e kaluara, dhe të cilat OSHP i ka determinuar si arsyetim të pabazë për anulimin e tenderit. Ndërkaq, në ciklin e pestë, OSHP përmes Vendimit të pestë dhe të fundit me numër 0167/26, vendosi të konsiderojë çështjen si “res judicata” – të gjykuar.

Megjithatë, Njoftimi i gjashtë i AK mospërfill në tërësi Vendimin e pestë të OSHP, dhe përsëri për qëllime tendencioze me baza diskriminuese dhe prolonguese anulon tenderin. Në këtë drejtim kemi shkelje të nenit 7, paragrafi 3 i LPP-së, i cili përcakton se:

“3. ...autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasisë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.”

Tolerimi dhe përsëritja e mëtutjeshme e këtyre praktikave përveç se vërtetojnë diskriminimin e OE nga ana e AK, po ashtu rrezikojnë që të legjitimojnë veprimet

diskriminuere në procedurë të prokurimit publik edhe pse këto veprime janë të jashtëligjshme, dhe si rezultat dekurajojnë operatorët ekonomik që të marrin pjesë si ofertues në tendere.

Rrjedhimisht, përveç kërkesës sa më poshtë, OE kërkon masa ndëshkimore ndaj Autoritetit Kontraktues dhe zyrtarëve përgjegjës për shkak të diskriminimit dhe refuzimit të zbatimit të vendimeve detyruese të OSHP-së.

Bazuar në të lartcekurat, kryesisht shpalljen e rastit si “res judicata” – çështje e gjykuar, nga Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Vendimit 0167/26, me respekt, kërkojmë nga OSHP që, pas shqyrtimit të kësaj Ankese, të merr:

VENDIM

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar Ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit e paraqitur nga Operatori Ekonomik PACS and Workflow System;
- II. ANULOHET** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, i datës 17.07.2026, për anulim të aktivitetit të prokurimit, si dhe Letra Standarde për tenderuesin e eliminuar, e datës 17.07.2026, për eliminimin e Operatorit Ekonomik PACS and Workflow System nga ky aktivitet i prokurimit; dhe

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Operatori Ekonomik PACS and Workflow System është i detyruar të mbrojë interesat e tij ekonomike dhe ligjore. Rrjedhimisht, në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore, OE në fjalë është i detyruar të veprojë me të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, përfshirë kërkesat për kompensim të dëmeve eventuale të cilat kanë ndodhur dhe do të shkaktohen.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje e “Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”;*
- b) një kopje e “Letrës Standarde të Kërkesës për sqarimin e tenderit”;*
- c) një kopje e “Vendimit të Autoriteti Kontraktues mbi kërkesën për rishqyrtim”.*

****Sipas Nenit III.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*